



EDUKIMI MJEDISOR



Edukimi mjedisor natyror i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme mjedisore dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Edukimi mjedisor është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e shqetësimeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese dhe, mbrojtjen e dashurinë për natyrën.



“Fillimisht ki një objektiv të qartë. Së dyti, gjej mjetet për ta arritur.

Së treti përshtat mjetet”

Aristoteli

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjedisve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit

Përmes kësaj përmbledhjeje mujore Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, përgjatë muajit shkurt 2023, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin; atyre që ndodhen pranë ZM-ve, në zonat rurale. Aktivitete janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **1080**

Specialistë të angazhuar **20**

Orë mjedisore të realizuara **54**

52 Shkolla të përfshira

2 Universitete të përfshirë

“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



4 shkurt 2024, Dita Botërore e Ligatinave

Në kuadër të "Ditës Botërore të Ligatinave" u zhvillua një orë e hapur mjedisore me nxënës të shkollës 9-vjeçare "Gjergj Vat Martini" Velipojë, përgjatë së cilës u diskutua mbi ligatinat dhe rëndësinë e këtyre ekosistemeve të veçanta. Ora e hapur mjedisore u zhvillua pranë Qendrës së Vizitorëve në Velipojë, pjesë e PUTM Lumi Buna – Velipojë dhe territoreve ligatinore përreth saj. Më pas, të gjithë së bashku zhvilluam një vizitë në zonën ligatinore Këneta e Gjerdafit si dhe birdwatching pranë kullës së vrojtimit.

7 shkurt 2024, orë mjedisore dhe mbjellje fidanësh në Tarabosh

AdZM Shkodër në bashkëpunim me Shkollën e Mesme Pyjore "Kolë Margjini" dhe me Federatën e Pyjeve dhe Kullotave Shkodër bëmë të mundur mbjelljen e 300 fidanë të llojeve pishë e egër (Pinus sylvestris) dhe Ilqe (Quercus ilex) në zonën e Taraboshit, pjesë e Rezervatit Natyror të Menaxhuar "Liqeni i Shkodrës" në kuadër të ditës së krijimit të Agjencisë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

22 shkurt 2024, mbillen 200 fidanë të llojit pishë e egër

Në kuadër të "Vitet të Pyjeve" AdZM Shkodër në bashkëpunim me EcoAlbania, Well Point, Natyralistët dhe gjimnazin "28 Nëntori" zhvilluam një aksion mbjelljeje në zonën e Taraboshit, pjesë e Rezervatit Natyror të Menaxhuar "Liqeni i Shkodrës". Gjatë këtij aksioni u mbollën 200 fidanë të llojit pishë e egër (Pinus sylvestris).

ligatinat birdwatching rezervat natyror i menaxhuar

Pishë e egër (Pinus sylvestris) AKZM në 9-vjetorin e saj

“EDUKIMI MJEDISOR”, BERAT



9 shkurt 2024, orë mjedisore

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare “1 Maji” vizituan qendrën e Vizitorëve të AdZM-së Berat. Ata janë mirëpritur nga punonjësit e administratës si dhe janë njohur me funksionet e institucionit, zonat e mbrojtura dhe protokollet e monitorimit të jetës së egër.

21 shkurt 2024, orë mjedisore

AdZM Berat zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Faslli Saliq”, Vodicë. Pyjet ishte tema e përzgjedhur nga specialistët për të zhvilluar me nxënësit, me të cilët realizuan edhe një mbjellje fidanësh në oborrin e shkollës.

“EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR

04



4 shkurt 2024, Dita Botërore e Ligatinave

Në Ditën Ndërkombëtare të Ligatinave, specialistët e AdZM-së Dibër realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Irfan Hajrullai”. Nxënësit u njohën me rëndësinë e ligatinave, vlerat e tyre dhe mënyrat se si ne duhet t'i mbrojmë ato. Në fund specialistët prezantuan një ilustrim të një ligatine dhe llojet bimore e shtazore që jetojnë aty, si dhe ndërveprimet mes tyre.

ligatinat

lloje bimore e shtazore

ndërveprimet mes llojeve

“EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



ekspeditë flora dhe fauna monumente natyre
ligatina shpendë autokton



1 shkurt 2024, kujtojmë AKZM-në në vitin e 9-të të saj

Në kuadër të datëlindjes së 9-të të AKZM-së u zhvillua një ekspeditë në Parkun Natyror “Qafë-Shtamë” me nxënësit e gjimnazit të përgjithshëm “Skënderbeu” në Krujë. Nxënësit u njohën me parkun, florën, funën dhe monumentet e natyrës.

2 mars 2024, Dita Botërore e Ligatinave

“Ligatinat, rëndësia dhe metodat për rehabilitimin e tyre”, ishte tema e trajtuar në kuadër të ditës së ligatinave, nga stafi i AdZM-së Durrës në bashkëpunim me PPNEA dhe nxënësit e gjimnazit “Dhosi Liperi” në Durrës. Po ashtu nxënësit u njohën me shpendët autokton, shumica migrator në zonën PTUM “Bisht Kamëz” dhe “Rrushkull”.

19 shkurt 2024, flora dhe fauna në PK “Qafë-Shtamë”

Specialistë të AdZM-së Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare në Cudhi Kamt, Krujë. Nxënësit u njohën me florën dhe faunën e Parkut Natyror “Qafë - Shtamë”

22 shkurt 2024, roli i pyjeve në mjedis

Stafi i AdZM-së Durrës zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare në Hamallaj, Durrës. Tema e përzgjedhur ishte “Roli i pyjeve në mjedis”, për të cilën specialistët ndanë informacione të detajuara mbi rëndësinë që kanë pyjet në jetën tonë.

“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



2 shkurt 2024, Dita Botërore e Ligatinave

Në kuadër të Ditës Botërore të Ligatinave specialistët e AdZM- së Fier zhvilluan një orë mjedisore në natyrë me nxënësit e Shkollës "Mihal Nako", Fierseman Divjakë. Biodiversiteti i Parkut Kombëtar "Divjak – Karavasta" dhe rëndësia e ligatinave për shpendët, ishin temat kryesore që u trajtuan gjatë kësaj ore. Gjithashtu nxënësit vajtuan shpendët në pjesët ujore të parkut. Ky aktivitet mjedisor u mbështet nga Projekti JICA.

2 shkurt 2024, ekspeditë kërkimore në terren

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Ligatinave dhe nismës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, duke e quajtur vitin 2024 "Viti i Pyjeve", studentë të Departamentit të Gjeografisë të Universitetit të Tiranës kontribuan ditën e sotme me një studim, pilotim kërkimor në terren me temë "Identifikimi gjeohapsinor i patologjive të drurëve pyjore në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta përmes përdorimit të teknologjisë GIS/GNSS/UAV". Nën kujdesin e stafit të AdZM Fier dhe udhëheqjen e Msc. Dritan Lloci, Prof.Asoc.Dr. Sonila Sinjari, Msc. Ornella Hasrama, ky departament përfundoi me sukses ekspeditën.

5 shkurt 2024, mbillen 200 fidanë pishë mesdhetare

Stafi i AdZM Fier u rikthye më datë 5 shkurt në Pishë Poro, për të vazhduar më tej nismën e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, duke e quajtur këtë vit "Viti i Pyjeve", por edhe dëshirën tonë për të shtuar sipërfaqet e gjelbërta. Së bashku me punonjës nga Prefektura e Qarkut, nxënës nga shkolla "Janaq Kilica" Fier dhe mbështetjen e Protection and Preservation of Natural Environment in Albania, u mbollën 200 fidanë pishë mesdhetare.

rëndësia e ligatinave ekspeditë identifikim gjeohapsinor
patologjia e drurëve pyjorë viti i pyjeve 2024 shpendë të zonave ujore

9 shkurt 2024, vizitë nga nxënësit e kolegjit “Turgut Ozal”

Nxënës nga Kolegji Turk "Turgut Ozal" Tiranë vizituan Parkun Kombëtar

“Divjakë-Karavasta”. Të asistuar nga Specialistët e AdZM Fier në qendrën e Vizitorëve, ata u njohën me vlerat natyrore të parkut. Në përfundim të vizitës, nxënësit mbollën edhe pishën e tyre të personalizuar me emrin e shkollës së tyre.

9 shkurt 2024, birdwatching në Godullë

AdZM Fier me nxënës nga shkolla jopubike “Berate” zhvilluan një aktivitet ku fillimisht u njohën me vlerat e parkut në qendrën e Vizitorëve dhe më pas zhvilluan “birdwatching” në Godullë, duke vrojtuar dhe njohur më tepër shpendët që jetojnë në këto habitate.

10 shkurt 2024, nxënës nga qyteti i Vlorës vizitojnë parkun

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Rilindja" Vlorë, kanë vizituar Parkun Kombëtar

“Divjakë-Karavasta”. Nëpërmjet specialistëve të AdZM-së Fier ata u njohën me vlerat natyrore, rreth florës dhe faunës së pasur që ky park ka. Gjithashtu nxënësit vrojtuan shpendët në zonat ujore të Parkut Kombëtar.

15 shkurt 2024, mbollëm së bashku me nxënësit 200 fidanë pishë

Rreth 60 nxënës të shkollës 9-vjeçare "Foto Puka", ju bashkuan specialistëve të AdZM- së Fier për mbjelljen e 200 fidanë pishë në Parkun Kombëtar “Divjakë- Karavasta”, ku mundën gjithashtu të njihen edhe me vlerat natyrore të parkut pranë qendrës së Vizitorëve, si dhe vrojtuan shpendët në ligatinat e tij.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



02	07	09	14	15	16	16	18	19	21	21	22	27
----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----

2 shkurt 2024, 24 vjetori i PK “Prespë”

Orë e hapur mjedisore me rastin e 24-vjetorit të Parkut Kombëtar të Prespës, në Monumentin e Natyrës “Shpella e Trenit” për njohjen e vlerave të Parkut Kombëtar të Prespës.

7 shkurt 2024, mbollëm 300 fidanë vërrë

Në bashkëpunim me PPNEA u mbollën 300 fidanë vërrë, në hyrje të Prespës së Vogël, në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare “Raif Kolami”, disa shkolla të mesme të qytetit të Bilishtit dhe shkollën e mesme të Pustecit.

9 shkurt 2024, orë mjedisore

Orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Hamdi Alin” të fshatit Leshnicë për t’u njohur me zonën e Mbrojtur të PMTU-Pogradec. Së bashku me nxënësit mbollëm edhe disa fidanë në oborrin e shkollës.

14 shkurt 2024, rënësia e monumenteve të natyrës

Orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Neim Muçelli” të fshatit Petrushë, ku nxënësit u njohën me rëndësinë e monumenteve të natyrës dhe përzgjedhjen e tyre në PMTU “Pogradec”, si dhe u zhvillua një aksion mbjellje në mjediset e oborrit të shkollës.

monumente natyre viti i pyjeve 2024 dita e inxhinierit të pyjeve

metoda e mbjelljes së fidanëve fole për zogjtë park natyror

15 shkurt 2024, viti i pyjeve 2024

Në shkollën 9-vjeçare "Gështenjas" u zhvillua një bisedë e hapur për vitin 2024 si viti i pyjeve dhe rëndësia e tij. Më pas nxënësit në bashkëpunim me subjektin mbështetës "2T", realizuan mbjelljen e 1500 fidanëve në aksin rrugor Qukës-Qafë Plloçë, pjesë e zonës së mbrojtur PMTU-Liqeni i

16 shkurt 2024, Dita e inxhinierit të pyjeve

Orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare 'Sheme Mahmutllari' në fshatin Rëmenj, në kuadër të "Ditës së Inxhinierit të Pyjeve" ku u bë një prezantim i punës së inxhinierëve të stafit të AdZM Korçë.

16 shkurt 2024, Dita e inxhinierit të pyjeve

U zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Raif Kolami" të fshatit Tren për t'u njohur me punën e inxhinierëve të pyjeve në kuadër të kësaj dite. Ora përfundoi me një aksion mbjellje fidanësh brend dhe bli në ambientet e oborrit të shkollës.

18 shkurt 2024, mbillen akacie pranë fshatit Gështenjas

Fidanë të llojit gështenjë dhe akacie u mbollën në afërsi të fshatit Gështenjas, pjesë e Peizazhit të Mbrojtur Tokësorë-Ujorë "Liqeni i Pogradecit", falë aksionit të ndërmarrë nga AdZM Korçë dhe nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Kajo Karafili". Fidanët ishin dhuratë e donatorëve, që zgjedhin të kontribuojnë për natyrën dhe mjedisin e ekosistemeve të zonave të mbrojtura.

19 shkurt 2024, njohim monumentet e natyrës

Në shkollën e mesme "Skënder Drubaku" të fshatit Rrodokal, u zhvillua një orë mjedisore e hapur në monumentin e natyrës "Rrapi Rrodokali", ku nxënësit u njohën me vlerat e monumentit, si dhe një aksion mbjellje fidanësh përreth ambienteve të oborrit të shkollës.

21 shkurt 2024, orë mjedisore

Nxënësit e shkollës së mesme "Petro Nini Luarasi" të qytetit të Ersekës, zhvilluan një vizitë në Monumentin e Natyrës "Plepat e Egër" Varisht, duke u njohur me vlerat dhe rëndësinë e tij.

21 shkurt 2024, njohja me metodat e mbjelljes së fidanëve

U realizua një aksion mbjellje fidanësh në shkollën e mesme "14 Ëngjëjt" të fshatit Starovë, ku nxënësit u njohën me sezonin dhe metodat e mbjelljes së fidanëve, si dhe mbollën 25 fidanë pishë të zezë dhe gështenjë.

22 shkurt 2024, aksion pastrimi në shtegun e Kalasë

Në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Kozma Gjoke Basho" Pogradec, u zhvillua një aksion pastrimi në shtegun e Kalasë, si dhe u mbollën 50 fidanë të llojit gështenjë nga nxënësit e kësaj shkolle.

27 shkurt 2024, nxënësit ndërtojnë fole për zogjtë

Në bashkëpunim me nxënësit e shkollës së mesme të Ndërtimit të qytetit të Korçës, u ndërtuan disa fole për zogjtë, të cilat janë planifikuar të vendosen në Parkun Natyror "Cangonj".

“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



02 shkurt 2024, Dita Botërore e Ligatinave

Specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Gostil” në kuadër të Ditës Botërore të Ligatinave, ku së bashku me nxënësit e shkollës “Gostil” vizituan MN “Kënetë e Kashtës”, Kukës. Nxënësit realizuan vizatime të kënetës, florën/faunën dhe zhvilluan biseda rreth rolit dhe rëndësisë së ligatinaveligatinave.

12 shkurt 2024, “mbill pemën tënde”

Në kuadër të sensibilizimit të nxënësve në shkolla me moton “Mbille pemën tënde”, AdZM Kukës në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare “Novosë”, inkurajuan nxënësit të mbjellin pemë frutore. Të pranishëm gjatë mbjelljes ishin edhe prindërit, që ndihmuan sipas një kontributi simbolik dhe duke përdorur mjete rrethore arka, goma, bidona të ndryshëm etj.

20 shkurt 2024, si të ruajmë planetin Tokë

Në kuadër të sensibilizimit të nxënësve të shkollave, u zhvillua një bisedë me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Ahmet Voka” Gostil, për idetë dhe nismat e ndryshme që mund të ndërmerren për ruajtjen e planetit Tokë.

22 shkurt 2024, orë mjedisore

Në kuadër të sensibilizimit të nxënësve të shkollave, u zhvillua një bisedë me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Krumë”, për idetë dhe nismat e ndryshme që mund të ndërmerren për ruajtjen e planetit Tokë.

ligatina

pemë frutore

ruajmë planetin Tokë

“EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



5 shkurt 2024, në 9-vjetorin e AKZM-së

Në 9-vjetorin e krijimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura stafi AdZM Lezhë së bashku me nxënësit e shkollës profesionale “Kolin Gjoka” realizuan një takim në qendrën e vizitorëve ku u njohën me biodiversitetin e larmishëm të Zonave të Mbrojtura. Bashkë me ta mbollëm 100 fidanë pishë e butë, si dhe shëtitëm përreth lagunës me biçikleta.

8 shkurt 2024, orë praktike në Lagunën e Vainit

Studentët e vitit të 3-të të degës Inxhinieri Pyjore, të Fakulteti i Shkencave Pyjore, realizuan një orë praktike në Lagunën e Vainit. Përmes stafit të AdZM-së Lezhë ata u njohën me rëndësinë e zonave ligatinore dhe biodiversitetin, përgjatë vizitës në lagunë.

15 shkurt 2024, llojshmëria biologjike në zonat e mbrojtura

Specialistët e AdZM-së Lezhë zhvilluan me nxënësit e klasës së IV-ët, të shkollës 9-vjeçare “Adriatik” një orë mjedisore, në lidhje me shumëllojshmërinë biologjike të zonave të mbrojtura. Theksi u vendos në ruajtjen e vitalitetit dhe llojshmërisë biologjike të jetës në tokë dhe përdorimi racional i burimeve natyrore. Me pas nxënësit të ndarë në grupe renditën karakteristikat e bimëve dhe kafshëve që rriten në zonën ku ata banojnë dhe dobia e tyre për jetën e njerëzve.

27 shkurt 2024, mjedis i pastër - jetë e shëndetshme

Në kuadër të edukimit mjedisor specialistët e AdZM Lezhë këtë radhë me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Nike Tome Prela” Gorre kanë zhvilluar një orë mjedisore me temë “Mjedis i pastër, jetë e shëndetshme”. Nuk munguan edhe pyetësorët e ndryshëm në klasë, që nxënësit realizuan në lidhje me temën.

biodiversitet

praktikë mësimore

llojshmëri biologjike



2 shkurt 2024, ligatinat si ekosisteme të çmuara natyrore

Në kuadër të Ditës Botërore të Ligatinave, specialistë të AdZM-së Tiranë në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Vilë Bashtovë”, realizuan një orë mjedisore mbi rëndësinë ekologjike të ligatinave dhe mirëmbajtjen e tyre për ruajtjen e biodiversitetit në PK “Divjakë-Karavasta”. Ky aktivitet u realizua në natyrë, për të qenë sa më pranë ekosistemit ligatinor, ku nxënësit me anë të dylbive vrojtuan shpendët që jetojnë në të. Ata gjithashtu identifikuan dhe disa prej llojeve të florës, që janë karakteristike për zonën. Qëllimi i kësaj ore mjedisore ishte: të kujtojmë rëndësinë e ligatinave si ekosisteme të çmuara natyrore.

06 Shkurt 2024, vizitë studimore në Muzeun e Shkencave të Natyrës

Në kuadër të 9-vjetorit të themelimit të AKZM-së, punonjësit e AdZM-së Tiranë së bashku me nxënësit e gjimnazit “Sami Frashëri” organizuan një vizitë studimore në Muzeun e Shkencave të Natyrës. Nxënësit me ndihmën e ekspertëve të muzeut u njohën me llojet e faunës si dhe me rolin që kanë gjallesat në mjedis.

13 Shkurt 2024, ndërtojmë stacione ushqimi për shpendët

Stafi i AdZM Tiranë së bashku me nxënësit e shkollës cikli i ulët “Brar”, me ndihmën e materialeve të riciklueshme realizuan një orë dedikuar shpendëve. Nxënësit me shumë përkushtim ndërtuan disa stacione të vogla ushqimi për shpendë të vegjël harabelorë, të cilat më pas i vendosën në degët e pemëve pranë mjedisve të shkollës, në mënyrë që të shihen nga të gjithë nxënësit. Aktiviteti u realizua me shumë kënaqësi dhe dashuri nga fëmijët, për të qenë pranë shpendëve dhe për t'i ndihmuar ato.

26 Shkurt 2024, njohim kafshët që jetojnë në PK “Mali i Dajtit”

Stafi i AdZM-së Tiranë së bashku me fëmijët parashkollor të shkollës fillore “Brar”, realizuan një orë mjedisore. Fëmijët u njohën me kafshët e egra që jetojnë në Parkun Kombëtar “Mali i Dajtit”. Ata u njohën edhe me disa paisje si (dylbi, kamera kurth, dron) të cilat ndihmojnë në vëzhgimin dhe ruajtjen e banorëve të pyllit. Në fund fëmijët u zbavitën me lojëra për gjetjen e kafshëve dhe me ngjyrosje të disave prej tyre, duke treguar në këtë mënyrë, dashurinë që ata kanë për kafshët.

rëndësia ekologjike e ligatinave stacione ushqimi për shpendët

shpendë të vegjël harabelorë dylbi, kamera kurth, dron



27 shkurt 2024, njohim 'banorët' e zonave të mbrojtura

AdZM Gjirokastrë në bashkëpunim me qendrën “Xhuzepe Grass” zhvilluan një orë mjedisore me fëmijët, për t'i njohur ata me llojet e kafshëve dhe shpendëve që jetojnë në territoret e zonave të mbrojtura.

“EDUKIMI MJEDISOR”, VLORË



3 shkurt 2024, aksion mbjellje

Me rastin e 9-vjetorit të krijimit të Zonave të Mbrojtura, së bashku me Ministren e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, bashkinë Vlorë dhe nxënës të moshave të ndryshme realizuam një aksion mbjelljeje pranë grykëderdhjes së Vjosës, PK “Lumi Vjosë”.

7 shkurt 2024, njohim pasuritë natyrore të Nartës

AdZM Vlorë në bashkëpunim me Njësinë e Integritetit Evropian në bashkinë Selenicë zhvilluan një orë mjedisore në Nartë. Nxënësit e shkollës “Mynyr Xhindi” u njohën nga afër me pasuritë natyrore të zonës.

@akzmalbania @akzmalbania @a_k_z_m

Copyright AKZM All rights reserved

“EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



06 shkurt 2024, orë mjedisore

Me nxënësit e shkollës së mesme "Ibrahim Muça" Librazhd, u realizua një orë mjedisore në lidhje me Parkun Kombëtar "Shebenik". Tema e prezantuar për nxënësit ishte biodiversiteti në Parkun Kombëtar "Shebenik". Ata u njohën me florën e pasur e të larmishme të parkut, si dhe mësuam edhe më shumë për monumentet e natyrës dhe destinacionet e shumta që parku ofron, për të gjithë vizitorët që dëshirojnë të shijojnë nga afër bukuritë natyrore të tij.

08 shkurt 2024, kujtojmë krijimin e AKZM-së

Në kuadër të aktiviteteve të ndërmara me rastin e krijimit të AKZM-së, së bashku me nxënësit e shkollës së Mesme të Bashkuar "Isak Alla" Zgosh, kaluam një ditë të mrekullueshme në Parkun Kombëtar "Shebenik". Ndalesa e parë ishte në qendrën e Vizitorëve në Fushë Studen, ku nxënësit u njohën me parkun dhe vlerat natyrore e mjedisore të tij. Një tjetër aktivitetet si pjesë e programit ishte dhe një ecje me biçikleta, të cilën nxënësit e përshkruan si një eksperiencë të mrekullueshme në park. Gjithashtu ata shfrytëzuan edhe praninë e dëborës për t'i shtuar edhe më shumë magji kësaj dite.

12 shkurt 2024, mbjellje fidanësh në vitin e pyjeve

Viti 2024 është konsideruar si viti i pyjeve. Në kuadër të këtij viti, AdZM Elbasan synon të kontribuojë në shtimin e sa më shumë hapësirave të gjelbra. Në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Isuf Gjura" Kuturman, u realizua një aktivitet mjedisor, siç ishte mbjellja e disa fidanëve të llojit pishë e zezë (Pinus nigra) në mjediset e shkollës dhe zonës rreth saj.

biodiversitet pishë e zezë (Pinus nigra)

monumentet e natyrës sensibilizim dhe ndërgjegjësim

13 shkurt 2024, orë mjedisore në natyrë

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Genc Leka" Librazhd, të shoqëruar nga stafi i AdZM Elbasan, patën mundësinë të njiheshin me vlerat natyrore, shtigjet dhe biodiversitetin e pasur të Parkut Kombëtar "Shebenik".

13 shkurt 2024, mbjellje me fidanë akacie

Në kuadër të vitit të pyjeve 2024, AdZM Elbasan në bashkëpunim me nxënësit e shkollës së Mesme të Bashkuar "Shefqet Dosku" Dorëz, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik" u realizua një aktivitet mjedisor siç është mbjellja dhe zëvendësimi i disa fidanëve të llojit akacie (*Robinia pseudoacacia*).

20 shkurt 2024, njohim vlerat e PK "Shebenik"

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës së Mesme të Bashkuar "Rahman Çota" Hotolisht, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik". Nxënësit u njohën me vlerat natyrore dhe mjedisore të parkut, si edhe me florën dhe faunën e tij, monumentet e natyrës dhe destinacionet e shumta të parkut. Orët mjedisore kanë si qëllim përcimin e njohjes, promovimit të vlerave të bukurive natyrore dhe mbi të gjitha përcimin e dashurisë për natyrën tek brezat e rinj, një temë me shumë interes për nxënësit.

21 shkurt 2024, njohim monumentet e natyrës së bashkisë Gramsh

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Afëz Berbiu" Gramsh, në afërsi të Parkut Kombëtar "Mali i Tomorrit". Gjatë kësaj ore mundëm të shpërfaqim vlerat natyrore dhe mjedisore të parkut, florën dhe faunën e tij, monumentet e natyrës, të cilat ndodhen në territorin e bashkisë Gramsh që administrohen dhe menaxhohen nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Elbasan.

22 shkurt 2024, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Daut Gurra" Dragostunjë, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik". Gjatë kësaj ore, nxënësit njohën vlerat natyrore dhe mjedisore të parkut, si florën dhe faunën, monumentet e natyrës dhe destinacionet e shumta të parkut.

28 shkurt 2024, ndërgjegjësojmë përmes veprimeve konkrete

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një aktivitet pastrimi me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Veiz Çota" Togz, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik" me qëllim sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e brezit të ri në kujdesin dhe mbrojtjen e natyrës.